

**Dëshmi mbi një alfabet original të shqipes nga shekulli XVII:
Kozmai i Durrësit si shpikës i mundshëm
i alfabetit të parë original të shqipes**

**Records about an original alphabet of Albanian from the
17th century: Cosmas from Durrës, author of the possibly
earliest original alphabet of Albanian.**

Abstract: A text in Greek has been lately discovered witnessing the existence of an original alphabet of Albanian towards the end of 1600s. The text comes from *Discourses on Helenism*, a book by Anastasius Michael, an Enlightenment academic. Published around 1710 in Amsterdam, only one signature is known so far to have survived from this book.

In it is mentioned the metropolitan bishop of Durrës Cosmas Mavrudi as inventor of an original alphabet of Albanian. Such signature has been republished with new commentary by the scholar Charalampos Minaoglou in 2013, and we bring it here in Albanian for the first time for a broad readership.

Cosmas had served as metropolitan bishop of Durrës from 1694 to 1702. However, in this essay we trace back Cosmas's life and deeds in Elbasan and investigate on the circumstances which must have prompted him into inventing an original alphabet for Albanian. His alphabet and writings are not known to scholars who conduct research on the earliest texts in Albanian.

Keywords: *Albanian alphabet, Anastasius Michael, Anonymous of Elbasan, Archbishopric of Ohrid.*

Dëshmi e panjohur për një alfabet shqip

Në Bibliotekën Kombëtare në Athinë ndodhet një kopje e fotografuar e një libri pa datë, me autor Anastas Mihail Maqedonasi (c. 1675–1725) që si përmbajtje ka shënime dhe përshkrime mbi grekët, gjuhën greke dhe vazhdimësinë mes grekëve të lashtësisë dhe atyre modernë. Ksombla e vetme e librit ka humbur; nga ajo ka mbetur vetëm një kopje e mikrofilmuar që ndodhet në Athinë, që ka mungesë të faqeve të para, dhe të pjesës pas faqes 216 (Minaoglou 2007: 307). Autori i këtij libri të hershëm, grek nga Nausa, ishte anëtar i Berlin-Brandenburgische Akademie në Gjermani, dhe

kish qenë veçanërisht aktiv në fillim të shekullit XVIII. Libri që njihet edhe me titullin *Περὶ ῥηγματικόν Πυκτάτιον*¹, duket e mundshme të jetë shtypur në Amsterdam në vitin 1710, megjithëse në mungesë të frontespicit kjo nuk mund të thuhet me siguri (Minaoglou 2018: 115–25). Pjesa që na intereson në këtë vëllim është një paragraf që flet për kryepeshkopin e Durrësit, qipriotin Kozma, si “Kadmi i shqiptarëve” që do të “nxjerrë shqiptarët në dritë.” Po e japim në origjinal paragrafin e librit:

Ὡς ἄρα ἦν περ τὰ ἄλλα τῶν ἐθνῶν βίβλοις ἐγγεγραμηνήν ἔχει σοφίαν, ταύτην αὐτοῦς, οἰοῦναι τὰ σφῶν, ὅπερ λέγεται, κατατραγόντας βιβλία, ἐνδόμυχον ἐνστερνίσασθαι. Ἐνθεν, ὅτε δεήσει, ἐκφέρουσί τε, καὶ ὡς ἐξ ἐμφύτου τινὸς ἀποστοματίζουσι τρίποδος. Ἐχει δὲ τι κομψὸν καὶ ταῦτα τῶν ἡμετέρων Ἀλβανιτῶν. Τὸ μέντοι τυχηρὸν τοῦτο αὐτῶν ἐλάττωμα ἐπιδιορθώσασθαι, οὐ μικρὰ ἐφρόντισεν ἀνὴρ σοφὸς Κοσμᾶς ὁ Κύπριος, ὃν καὶ τῆς Δυρράχου Ἐπισκοπῆς ἱερὸν κοσμήτορα ὁ λόγος ἰστόρησε. Καὶ εἰ μὴ τι ἄρα τῶ ἀνδρὶ, ὑπὸ λιπαροῦ γήρατος, νόμοι φύσεως φθάσαντες ἐπιτάξειεν, οὐδὲν ἴσως ἔσεται τὸ κωλύον του μὴ καὶ τοῦτον Κάδμόν τινα τοὺς Ἀλβανοὺς ἀναφανῆναι, στοιχείοις τοῖς τῆς ἀνθρωπίνης ἐναρμονίου φωνῆς τὴν ἐκείνων γλῶσσαν κοσμήσαντα. (Mihaili 1710: 62–3)

Gjuha e përdorur nga autori është greqishtja e vjetër,² kurse tipshkronjat janë plot me ligatura që gjithsesi nuk e lehtësojnë punën e përkthimit të paragrafit të mësipërm. Me ndihmën edhe të studiuesit Aristotel Spiro³ po e japim këtu sprovën e përkthimit:

Pra, sigurisht sikundër kombet e tjera urtinë e tyre e shkruajnë nëpër libra, këtë urti ata [shqiptarët], e përthekojnë me lehtësi vetëm përmes rrëfimeve. Kështu, kur u duhet, si prej ndonjë instinkti, mësojnë edhe pa lexuar nga librat. Ka diçka elegante edhe ndër shqiptarët tanë. Por për të ndrequr këtë mangësi fatlume të tyren, u kujdes mjaft një burrë i urtë, Kozma Qiprioti, i peshkopatës së Durrësit, të cilin ligjëratat e tij e kanë përvijuar si

1 “Udhëpërshkrime”. Minaoglou më vonë e quan *Fjalime mbi Helenizmin* (Λόγος περί Ἑλληνισμού), pasi titulli origjinal nuk dihet me siguri për shkak të mungesës së faqeve.

2 Sipas Minaoglou, gjuha e përdorur nga Mihail Maqedonasi, ishte greqishte arkaike *humaniste* (2018: 115).

3 Përkthimin nga z. Spiro, të cilin e falënderojmë, e kemi pranuar me këtë përshkrim për të treguar kujdes: “Pasazhi megjithëse është shkruar në shekullin XVIII, është në greqishten e vjetër. Duket se Anastas Mihaili e njihte shumë mirë greqishten e vjetër, aq sa për të na e bërë shumë të vështirë përkthimin. Megjithatë, unë bëra një përpjekje të parë përkthimore për të dalë nga errësira semantike. Përkthimi (provizor, pra edhe i parekomandueshëm për t’u përfshirë në një botim) që unë arrita është ky...” Përkthimi që po japim këtu ka disa ndryshime nga versioni i dërguar nga z. Spiro.

një kujdestar të shenjtë. Dhe nëse atyre burrave, pleq të përvojtur, ligjet e natyrës nuk do t'i vinin poshtë, nuk do të ketë ndoshta asnjë pengesë që ky Kadmi i ri t'i nxjerrë shqiptarët në dritë, përmes elementeve të zërit të harmonishëm njerëzor duke zbukuruar gjuhën e tyre.

Janë tri çështje që bien në sy këtu. E para, figura e Kozma Qipriotit, si emër gati i panjohur për historiografinë shqiptare, që qenka marrë me gjuhën shqipe. E dyta, prania e disa teksteve në gjuhën shqipe në kapërcyell të shekullit XVII, mbase të panjohura deri më tash. Dhe e treta, referimi i Kozmait si “Kadmi i shqiptarëve” që pas gjasash nënkupton edhe shpikjen e një alfabeti për gjuhën shqipe.⁴ Veçanërisht kjo pjesa e fundit kishte cytur studiuesin grek Charalampos Michaoglu për të propozuar Kozmain e lartpërmendur si autor të alfabetit të *Anonimit të Elbasanit* (Minaoglou 2013: 37).⁵ Kozmai, një figurë kosmopolite e kohës — si do ta shohim edhe në vazhdim — ishte shpërngulur në Elbasan dhe kishte shërbyer si kujdestar i manastirit të Shën Gjon Vladimirit nga viti 1682. Në vitin 1694 ishte emëruar mitropolit i Mitropolisë së Durrësit, me seli në të njëjtin manastir.

Kadmi i shqiptarëve

Për jetën e Kozmait të Durrësit, në dallim prej shumë figurave të kohës me pozita edhe më të larta në hierarkinë kishtare, kemi në dispozicion relativisht shumë të dhëna.⁶ Shënime të para më të dendura për të i gjejmë nga studiuesit Emil Legrand (1903) dhe Ivan Snegarov (1932). Kishte lindur më 15 qershor 1643 në Tunis me emrin Kostandin Mavrudi.⁷ Babanë, Dhimitrin, e kishte nga Selaniku, e nënën, Elizabetën, nga Qipro. Ishte regjistruar në Kolegjin e Shën Thanasit në Romë më 11 nëntor 1660, megjithëse e kishte kaluar moshën e rregullt të studimeve aty. Pas emërimit si dhjak, më 9 maj 1663, për shkaqe shëndetësore i kish ndërprerë studimet më 26 gusht të vitit vijues (Legrand 1903: 400). Nga aty nuk është e qartë nëse ka shkuar në Tunis apo në Jerusalem. Por në vitin 1666 nga Tunisi ishte shpërngulur në Paris, së bashku me konsullin francez Jacob de Molina. Kishte shërbyer si përfaqësues i kryepeshkopit

4 Fjalja pasuese thotë “Ἡτις πάμπαν ἰδιαίτατόν τινα, καὶ ὅλως ταῖς τῶν ὁμόρων ἐθνῶν ἀκοινώνητον γλώσσαις, ἐπιφαίνει χαρακτηριστῆρα τύπου.”

5 Duhet theksuar se Minaoglu është i mendimit që Kozmai mund të jetë autor i alfabetit, por jo i tekstit të Anonimit të Elbasanit.

6 Sa për krahasim, për Danielin paraardhësin e tij në mitropolinë e Durrësit ka krejt pak të dhëna (cf. Snegarov 1932: 222).

7 Ose Mavruku. Sipas Legrand, në regjistrat zyrtarë të shkollës ishte regjistruar kështu: “Constantinus seu Cosmas Maurukes filius Demetrii Mauruki et Elisabethe” (Legrand 1903, f. 400)

të Aleksandrisë Paisius (1657–1677) në të dy vendet. Në Paris kish gjetur mbështetjen e mbretit Luigji XIV (1643–1715) të Francës. Me ndihmën e konsullit francez në Qipro, Balthasar Sovan, ishte bërë kryepeshkop i dioqezës së Qipros, post që e mbajti shumë shkurt, vetëm disa muaj, mes viteve 1675 dhe 1676. Snegarov ishte i mendimit se e kishin larguar nga aty për shkak të “katolikofilisë” së tij (Snegarov 1932: 223–4).

Pas një jete dinamike e në lëvizje, duke shërbyer e punuar mes orientit dhe oksidentit — Romë, Qipro, Paris e Tunis — më 25 maj 1682, në moshë 39 vjeçare, u vendos në Elbasan, ku edhe veproi deri në fund të jetës së tij.⁸ Për një kohë të gjatë shërbeu si mbikëqyrës (igumen) i manastirit të Shën Gjon Vladimirit, pak kilometra larg qytetit të Elbasanit, e më pas, më 24 janar 1694 u emërua kryepeshkop i Mitropolisë së Durrësit (cf. Gelzer 1902: 57). Nuk e dimë pse Kozmai kish vendosur të shkonte në Elbasan; është e mundur që problemi me bindjet e tij në Qipro të ketë qenë faktor. Për më shumë, Elbasani në këtë kohë nuk ka qenë rajon i parëndësishëm. Vetëm dymbëdhjetë vjet para zbakimit të Kozmait në qytet, udhëpërshkruesi osman Evlia Çelebi që kishte kaluar ca kohë aty, e përshkruante Elbasanin si “nusja e Shqipërisë,” dhe për aktivitetin intelektual e cilësoje si “shtëpi e poetëve”.⁹ Duke qenë qytet me rëndësi në rrugën Via Egnatia, Elbasani ishte jo vetëm qendër e mitropolisë së Durrësit, por si kryeqendër e sanxhakut aty mbledheshin edhe taksat nga porti i rëndësishëm i Durrësit (Saraçi 2021: 40–4; Saraçi 2016: 46; Caka 2016: 99–113).

Në këtë kohë Elbasani kishte 18 lagje myslimane, edhe 10 lagje me “infidelë grekë, shqiptarë e latinë” (Elsie 2003: 209). Kishat ortodokse të qytetit ishin nën administrimin e Patriarkanës së Ohrit, e cila ishte kishë ortodokse autoqefale, në gjenezë bullgare, nën juridiksionin e Patriarkanës së Stambollit. Por mes viteve 1650 dhe 1700 dominimi i klerikëve të Patriarkanës së Stambollit, të njohur edhe si *fanariotë*, kishte bërë që veçoritë lokale — që nuk ishin greke — të Patriarkanës së Ohrit të cenoheshin, duke nxitur kështu një lëvizje lokale që Glezer e quan *autoktoniste*.¹⁰ Kjo lëvizje përbëhej prej klerit që vinte nga shtresat

8 Për datën e saktë të ardhjes së tij në Elbasan, tregon një shënim që ishte regjistruar në Kodikun e Manastirit të Shën Gjon Vladimirit, e që Visarion Xhuvani ia kishte dërguar në Berat arkimandritit Kallinikos Delikanis, më pas mitropolit po aty. Delikanis këto shënime i ka botuar në vitin 1902 si pjesë e vëllimit të dytë të *Dokumenteve Kishtare të Patriarkanës*, ku kish përmbledhur shënime dhe dokumente të ndryshme nga kishat ortodokse greke: shih Delikanis (1902: 867–8).

9 Udhëpërshkruesi osman Dervish Mehmed Zilli (1611–1684), i njohur me emrin e penës Evlia Çelebi vizitën në Elbasan e ka bërë në vitin 1670. Pjesa e Elbasanit e përktihyer në anglisht nga Robert Elsie (cf. Elsie 2003: 205–18).

10 Historiani dhe filologu gjerman Heinrich Gelzer (1847–1906) në vitin 1902 ka botuar përmbledhjen e tij të historisë së Patriarkanës së Ohrit, ku përveç tjerash janë të transkriptuara edhe disa dokumente në të cilat i ka nënshkruar Kozmai i Durrësit.

popullore të rajonit, pra nga “shqiptarët, arumunët e bullgarët” (Glezer 1902: 151). Gjatë kësaj periudhe të turbullirave 19 kryepeshkopë të ndryshëm ishin vendosur në krye të Patriarkanës së Ohrit. Sa për ilustrim, në vitin 1688, në krye të Patriarkanës së Ohrit ishte vendosur Germanos (me gjasë *fanariot*), i cili vetëm dy vjet më vonë ishte larguar nga aty “për shkak të keqmenaxhimit” (Glezer 1902: 147) — me siguri i shtyrë nga presioni i *autoktonistëve*. Amulli e tillë me mandate të shkurta kishte zgjatur deri më 6 shkurt 1719 kur *autoktonisti* Joasafi nga Voskopoja ishte vënë në krye të këtij institucioni fetar dhe kishte sjellë stabilitet duke drejtuar deri më 22 tetor 1745, për 26 vjet.

Sipas Snegarov, edhe Kozmai kish qenë pjesë e *autoktonistëve* (Snegarov 1932: 225). Lidhja e tij me komunitetin lokal shihet veçanërisht në vitin 1690, kur ai shfaqet si redaktor i shërbesës së parë të shtypur kushtuar Shën Gjon Vladimirit — shenjtit lokal, emrin e të cilit edhe e mbante manastiri ku ai qëndronte afër Elbasanit. Kjo shërbesë, e shtypur në Venedik, ishte financuar nga një elbasanas me emrin Joan Papa¹¹, i cili veprën ia kishte kushtuar bashkëqytetarëve të tij, “[q]ytetarëve të Neokastrit [Elbasanit] dhe të tjerëve nga Joan Papa me përulje ndaj Perëndisë” (1690: 5). Për *vitan* e shenjtorit elbasanasi kishte kërkuar ndihmën e igumenit të manastirit, Kozmait, së bashku me të tjerët që shërbenin aty,

...i kam shkruar shumë të ndriturit e të urtit, të dikurshmit mitropolit të Kitisë nga ipeshkvia e Qipros, zotëriut Kozma, njeriut të ditur e me shumë virtyre, që drejton manastirin e të shenjtit dhe me tokat tona, dhe e kam lutur të më dërgojë shërbesën dhe jetëshkrimin e të shenjtit, që ndodhen aty, për ta botuar në shtyp, që të mund të përdoret nga priftërinj në shërbim të tyre. Ashtu ma dërgoi, të përmirësuar te ato pjesë që mungonin, dhe duke shtuar ca të tjera, ja ku po e shtypim qysh po e shihni... (Kozmai 1690: 6)

Sipas Gelzer, dy autoktonistët kryesorë që kishin drejtuar Patriarkanën e Ohrit kishin qenë Zosima i Sisanit (1695) dhe Joasafi i Voskopojes (1719). Gelzer i ndante dy rrymat në *fanariote* dhe *autoktoniste*. Për historikun kronologjik të Patriarkanës shih tutje Glezer (1902: 131–68).

- 11 Joan Papa mbetet i panjohur si figurë e kohës. Për të dimë se e kishte financuar botimin e shërbesës për Shën Gjon Vladimirin, dhe ca informata të pakta nga vetë parathënia e botimit. Në kohën e botimit në 1690 duhet të ketë qenë në Venedik (ku është bërë shtypi), kurse me siguri ishte nga Elbasani, sepse elbasanasve të cilëve ua dedikon veprën i quan “bashkëvendas”. Snegarov kishte vënë re se ky nuk kishte qenë prift, për shkak se Papa në rastin e tij është mbiemri dhe jo para emrit (1932: 350). Te shënimet e Kozmait nga manastiri i Shën Gjon Vladimirit, përmendet edhe një emër tjetër Apostol papa *Αποστολη παπα* (sic), si igumen (Delikanis 1902: 67). Nuk e dimë në këtë rast nëse Papa është mbiemër i familjes, dhe nëse po, nëse kishte ndonjë lidhje me Joan Papën. Një Joan Papa shfaqet edhe në regjistrat e përfaqësuesve të tregtarëve të Durrësit në Venedik rreth vitit 1699. Duhet të jetë fjala për të njëjtin person (cf. Saraçi 2016: 84).

Kozmai ka nënshkruar edhe në një nga himnet e shërbesës. Por çështja nëse ai ka qenë autor i gjithë përmbledhjes është temë e diskutuar (cf. Novakovic 1893, Legrand 1902, edhe më rishtas nga Rëmbeci 2017, Nedeski 2017, Giakoumis 2014). Teksti i Anastas Mihailit rreth vitit 1710 që e vendos Kozmain edhe si autor të veprave në gjuhën shqipe, mund të ndihmojë edhe në këtë diskutim.¹² Shërbesa për Shën Gjon Vladimirin e shkruar në gjuhën greke, ka shpesh shprehje si “të dashur vendas,” apo “atdheu ynë” e “tokat tona.” Gjithashtu, referimet Shqipëri, Iliri, Bullgari e Serbi, janë të vazhdueshme. E në anën tjetër, nuk përmendet në aspekt pozitiv populli grek, apo ndonjë entitet i ngjashëm për Greqinë.¹³ Që mund të jetë dëshmi e afrisë së tij me lëvizjen *autoktoniste* për të cilin ka folur Glezer. Në pjesën e vargjeve kushtuar Shën Vladimirit, është kjo strofë, “O Joan i bekuar, krenaria (κλεος) e Shqipërisë, nderi (δοξα) i Ilirisë” (Kozmai 1690: 48),¹⁴ e tjetërkund edhe “mbret i dikurshëm i gjithë tokës së Ilirisë dhe Shqipërisë, Bullgarisë, Mizisë, Dalmacisë e Serbisë” (Kozmai 1690: 46). Me një terminologji të tillë është i mbushur i gjithë botimi.

Në faqen e fundit të shërbesës së botuar, është edhe një shkrim i shkurtër, por me interes për ndërtimin e manastirit të Shën Gjon Vladimirit në Elbasan. Shkrimi, që me siguri ish bazuar në mbishkrimet e manastirit

12 Një ndër dilemat kryesore mbi autorësinë e shërbesës mbështetet te një fjali në parathënie, ku shënimet e shërbesës që i kishte kërkuar Joan Papa ishin ato “që ndodhen aty,” pra në manastirin e Shën Gjon Vladimirit. Së këndejmi, pandehet se Kozmai vetëm i kishte dërguar si të gatshme materialet. Sa i përket himneve, në njërën prej tyre është një shkrim akrostik i njëfarë Danieli, i përbërë nga shkronjat e para të vargjeve. Sipas Nedeski ky Daniel, që sipas tij është Danieli metropolitit pararendës i Durrësit, duhet të jetë autor i gjithë himneve (përveç njërit ku ka nënshkruar Kozmai) (cf. Nedeski 2017: 45–50). Vijë të ngjashme mendimi ka edhe Rëmbeci, i cili *vitan* e shenjtorit e lidh me një dorëshkrim që ndodhet në Moskë (2017: 80–1). Nuk kemi hapësirë këtu të zgjerohemi më tutje mbi këtë diskutim. Për ne është tregues me rëndësi që Joan Papa i kishte kërkuar nga *Kozmai* materialet për Gjon Vladimirin, dhe jo nga Danieli apo ndonjë tjetër. Gjithashtu, fakti që brenda tekstit, te pjesa e sinaksarit të shkruar nga Kozmai përshkruhet qartazi procesi i mbledhjes së materialeve, na duket dëshmi shtesë që ai e kishte redaktuar dhe përpiluar. Joan Papa në po të njëjtën parathënie, duke iu referuar Kozmait thotë, “[a]shtu ma dërgoi, të përmirësuar te ato pjesë që mungonin, dhe duke shtuar ca të tjera” (1690, po aty). Pra është e qartë që Kozmai nuk e kishte sajuar shërbesën, por e kishte përpiluar atë nga informatat që kishte mbledhur. Te sinaksari Kozmai thotë, “[k]y është një sinaksar i bukur e i shkurtër i të shenjtit. Në librin e madh kishte më shumë edhe për shërbesën edhe për jetën, por [ky libër] ka humbur” (1690: 42). Në anglisht thonë: *if it looks like a duck, swims like a duck, and quacks like a duck, then it probably is a duck.*

13 Me gjithë këtë, vetë teksti është në gjuhën greke. Në fakt grekët quhen *ρωμαϊς* (romakë), gjë e rregullt për kohën. Si në rastin kur flitet për nënën e Shën Gjon Vladimirit *αυνα ρωμαϊς* (f. 37). Në shumicën e rrëfimit *ρωμαϊς* janë kundërshtarët e Gjon Vladimirit nga Bullgaria.

14 Ω Ιωανο μακαρ, τής Αλβανίας κλεος, Ιλλυρικού ή δοξα.

— të cilat sot ndodhen në Muzeun Kombëtar në Tiranë — tregojnë për rindërtimin e bërë në vitin 1381 nga mbreti i *χωρας αλβάνου* Karl Topia. Sipas këtij teksti, manastiri kishte qenë i shkatërruar paraprakisht për shkak të një tërmeti që kishte goditur më 1380 (cf. Rëmbeci 2017: 82). Karl Topia përmendet edhe në pjesën e sinaksarit (1690: 36–42), në të njëjtën pjesë ku përshkruhen edhe ngjarje të mëvonshme me lipsanet e Gjon Vladimirit. Sipas ngjarjes, disa ‘francezë’ i kishin marrë ato dhe i kishin hedhur tutje në lumin Shkumbin. Por, ca kohë më pas ato ishin kthyer përsëri në manastir. Në bazë të kësaj ngjarjeje, Kostandin Shpataraku në vitin 1739 kishte realizuar një pikturë me 12 pamje nga jeta e Shën Gjon Vladimirit.¹⁵ Shërbesa e vitit 1690 kishte qenë e para e shtypur për Shën Gjon Vladimirin në gjuhën greke,¹⁶ dhe kishte shërbyer si model edhe për shërbesat në gjuhët tjera në greqisht, bullgarisht, serbisht, e shqip.¹⁷

Kozmai pas emërimit si mitropolit i Durrësit, vazhdoi shërbimin në manastirin e Shën Gjon Vladimirit, deri në vdekjen e tij me 15 janar 1702. Vdiq në Durrës në shtëpinë e një banori lokal,¹⁸ dhe është varrosur në kishën e Shën Gjergjit në Durrës (Delikani 1905: 867).

Alfabetet origjinale shqipe dhe Kozmai i Durrësit

Alfabeti më i hershëm origjinal i datuar për gjuhën shqipe duhet të jetë i ashtuquajtur i alfabeti i *Kodikut të Beratit*. Disa shkronja të këtij alfabeti përkrijnë saktë me ato në mbishkrimin e gravurës së Ardenicës që mban datën 1731. Data më e hershme pranë ca shkronjave të një alfabeti origjinal të shqipes. Të njëjtat shkronja përkrijnë edhe me një alfabetin tjetër misterioz në faqen e parë të *Anonimit të Elbasanit*. Kjo faqe përmban një tekst që vazhdon të mbetet i padeshifruar në tërësi. Në *Kodikun e Beratit*, që vjen nga fundi i shekullit XVIII, gjithsesi pas vitit 1768, alfabeti është i përshkruar mirë, dhe me të janë shkruar edhe dy rreshta tekst në gjuhën shqipe. Ndërkaq te gravura e Ardenicës ky alfabet është përdorur

15 Sot kjo vepër ndodhet në Muzeun e Artit Mesjetar në Korçë (Giakoumis 2014: 207).

16 Shërbesa e përpiluar nga Kozmai duket të ketë qenë e suksesshme. Në vitin 1774 ajo ishte ribotuar bashkë me parathënien nga Joan Papa, këtë herë me mbështetje të voskopjarit Nikolaos Dimitriou Doruta (Petit 1926: 121–3). Ky botim, i realizuar po në mënyrë të njëjtë, po në Venedik, sot është shumë i rrallë. Ai kishte pasur pak ndryshime nga botimi i parë i vitit 1690, ndër të cilat edhe disa rreshta shtesë të pjesa e vargjeve, nga mësuesi elbasanas Theodor Haxhifilipi, një tjetër krijues i një alfabeti origjinal për gjuhën shqipe. Rreshtat e shtuar nga Haxhifilipi i gjejmë edhe në botimin tjetër të vitit 1858, po në Venedik (f. 33–36).

17 Një kronikë e njohur si Kronika e Priftit të Dioklesë, e ruajtur vetëm në gjuhën latine, në një përshkrim më të vonë, konsiderohet më e vjetra për Shën Gjon Vladimirin, nga fundi i shekullit XV (cf. Nedeski 2017: 42).

18 Me emrin *Νικόλα Πουλημμενου*.

vetëm për ndonjë shkronjë të mbishkrimi në shqip dhe ai në arumanisht (cf. Demiraj 2019: 108–24). Një tjetër alfabet i hershëm original haset në pesëdhjetë e ca fletët e dokumentit që njihet si *Anonimi i Elbasanit*. Megjithëse ky dorëshkrim nuk mban datë, ka hipoteza se mund të jetë nga fundi i shekullit XVII, datë që përkon me kohën kur vepronte edhe Kozmai i Durrësit. Alfabetet e tjera origjinale të gjuhës shqipe vijnë më vonë, dhe për to gati me siguri njihen autorët (Todhri, Vellarai, Veqilharxhi). Së këndejmi, janë tri hulli që mund të ndiqen sa i përket një alfabeti origjinal të shqipes të shpikur nga Kozmai. E para, se ai kishte shpikur alfabetin e *Kodikut të Beratit*; E dyta, se ai kishte shpikur alfabetin e *Anonimit të Elbasanit*; Dhe e treta, se ai ka shpikur ndonjë alfabet tjetër që nuk ka shpëtuar në asnjë formë deri më sot. Prej këtyre tri hullive, vetëm e dyta na jep shteg për qëmtim të mëtutjeshëm. Alfabeti i *Kodikut të Beratit* nuk është i dokumentuar sa duhet për një shtjellim më të gjerë,¹⁹ kurse për ndonjë alfabet të panjohur s’ka çka të thuhet më shumë, përveç se është mundësi reale të ketë ekzistuar.

Data dhe autori i Anonimit të Elbasanit

Anonimi i Elbasanit është një fletore krejt e vogël me gjashtëdhjetë e dy faqe gjithsej, prej të cilave 59 janë tekst. Është zbuluar në janar të vitit 1949 mes shënimesh dhe materialesh të mbledhura nga manastiri i Shën Gjon Vladimirit në Elbasan. Si përmbajtje përbëhet nga copëza të ungjillit të përkthyer shqip me një alfabet origjinal prej dyzet shkronjash, përfshirë ligaturat. Studimet e para mbi të janë bërë nga Dhimitër Shuteriqi (1949) e Injac Zamputi (1951) të cilët edhe e kishin deshifruar alfabetin. Duke qenë i padatur e pa nënshkrim autori, i kishin vënë emrin *Anonimi i Elbasanit*. Në vitet e dekadat në vazhdim ishin bërë edhe përpjekjet e para serioze për datimin e dokumentit dhe për gjetjen e autorit, prej të cilave dy janë kryesoret: ajo e Dhimitër Shuteriqit që përcakton si datë fundin e shekullit XVII dhe si autor një prift elbasanas me emrin Papa Totasi; dhe ajo e Mahir Domit që si datë të *Anonimit* e nxjerr 1761 dhe për autor tipografin voskopojar Grigorin e Durrësit. Kjo e dyta e mbështetur më vonë me argumente shtesë edhe nga Robert Elsie. Do të vendosim në paralele argumentet e këtyre dy hipotezave kryesore dhe t’i krahasojmë ato edhe me argumentet për një hipotezë të tretë që e nxjerr Kozma Mavrudin si autor të *Anonimit të Elbasanit*.

Hipoteza e Shuteriqit. Dhimitër Shuteriqi, që e ka zbuluar fletoren në vitin 1949, ndiqte kursin e mendimit që e vendoste një prift (deri atëherë)

19 Nëse i mbahemi idesë që në vitin 1731 Nektar Tërpo kishte përdorur ca germa nga një alfabet origjinal i kohës, nuk është krejt e pamundur që ky alfabet të ketë qenë ai i Kozmait. Kjo do ta shpjegonte deri diku edhe shtrirjen e gjerë të gjurmëve të këtij alfabeti në Elbasan, Fier e Berat.

të panjohur elbasanas me emrin Papa Totasi si autor të këtij dorëshkrimi. Këtë supozim e bazonte në një fakt shumë të thjeshtë, dhe për mendimin tonë të arsyeshëm, që në kapakun e *Anonimit*, me germa greke, është i shënuar ky emër: pra, παπα τoτaσι. Dhe ky emër është shkruar, siç vëren Shuteriqit, me të njëjtën ngjyrë si edhe vetë teksti i dorëshkrimit (Shuteriqi 1978: 91). Më pas, duke ndjekur argumentin e “arkaizmave në gjuhë” Shuteriqi ka dhënë edhe supozimin tjetër se dorëshkrimi i takon shekullit XVII (Shuteriqi 1965: 397). Sipas analizës së tij gjuhësore, e mbështetur edhe nga analiza e Injac Zamputit paralelisht, është vënë re se dorëshkrimi ishte shkruar me një miks dialektesh, me fjalë kryesisht nga gegërishtja, por edhe nga toskërishtja, me disa ngjyime gjuhësore edhe të elbasanishtes tipike. Shuteriqi mbante vijën e Zamputit se shumë fjalë ngjasonin edhe me ato të përdorura nga autorët e vjetër të Veriut (cf. Domi 1965: 273, 276). Më vonë Shuteriqi e kishte plotësuar më tutje hipotezën e tij, duke lënë të hapur mundësinë që edhe njëfarë Theodhor Bogomili të ketë qenë autor i dorëshkrimit (Shuteriqi 2012: 17). Por, studiuesi i shquar edhe në shkrimet e tij të mëvonshme asnjëherë nuk ka arritur të japë informata të tjera të gjetura për ndonjërin prej këtyre emrave.

Hipoteza e Domit. Mahir Domi në anën tjetër, ndërkohë që zhvillonte kërkime për të hartuar historinë e letërsisë së vjetër shqipe në vitin 1955, që thelluar në çështjen e *Anonimit të Elbasanit*, dhe më 1964, në Konferencën e Parë të Albanologjisë ka dhënë një supozim të tij. Sipas Domit, autor i *Anonimit* mund të ishte tipografi voskopojar i njohur me emrin Grigori i Durrësit, kurse si datë të mundshme të shkrimit i kishte vënë vitin “1760 ose 1761” (Domi 1965: 170–7). Hipotezën e tij Domi e kishte bazuar në një shënim nga koleksionisti i hershëm grek Georgios Zaviras (1744–1804), i cili në mesin e shënimeve të tij bibliografike kishte edhe një rresht — të mirënjohur për studiuesit — që daton më 1761 dhe flet për Grigorin e Durrësit, si botues të veprave në Voskopojë, dhe “përkthyes në shqip i Dhjatës së re dhe të Vjetër me një alfabet që ka shpikur vetë” (Zaviras 1872: 273). I njëjti Grigor, rreth vitit 1748 ishte emëruar metropolit i Durrësit dhe kishte qëndruar te manastiri i famshëm i Gjon Vladimirit në Elbasan (cf. Rugova 2022: 115–9). Në artikullin e botuar, Domi jep edhe kritikën e tij ndaj hipotezës së Shuteriqit për autorin e mëtuar elbasanas Papa Totasin, dhe në veçanti kundërshton argumentet për gjuhën arkaike të dorëshkrimit. Sipas Domit, gjuha e *Anonimit* thjesht kishte më shumë ndikim nga toskërishtja (Domi 1965: 276–7). Teza e Domit u përkrah më vonë edhe nga Robert Elsie, e pjesërisht edhe nga Injac Zamputi.²⁰ Janë edhe dy argumente që Domi thekson në tezën e shtruar: ndikimin sllav në alfabetin e *Anonimit*, dhe (njësoj si Shuteriqi) praninë e fjalëve nga autorët e vjetër të Veriut (Budi, Bardhi, Bogdani).

20 Cf. Elsie 1995, dhe Zamputi 1965.

Pikërisht këto dy argumentet e fundit — mbase është e dukshme — janë në favor të një hipoteze me Kozmain si autor të *Anonimit të Elbasanit*. Tezat e Shuteriqit dhe Domit përmbajnë pika mjaft bindëse. Është veçanërisht ajo e Domit e cila mbështetet qëndrueshëm në të dhënat e kohës. Por, siç ndodh shpesh me çështjet e historisë, kur nuk kemi burime parësore kualitative, na duhet të bazohemi në burime të tjera dytësore sasiore. E këto të fundit rrallë herë sjellin rezultate përfundimtare. Idetë e propozuara më lart nuk mund të hidhen poshtë, të paktën jo me të dhënat që zotërojmë sot, veçse ato, ftojnë që kërkimet mbi këtë çështje të mos ndalen. Ndoshta është kjo arsyeja, që bazuar në çka është thënë, të ndjekim gjurmët e reja, si ajo e Anastas Mihailit më 1710. A është e mundur që qiprioti Kozmai i Durrësit, figurë që kishte parë botën përgjatë gjithë jetës së tij, e që njëzet vitet e fundit të jetës i kishte kaluar në Elbasan me shqiptarët, të ketë përkthyer pjesë të ungjillit në gjuhën shqipe me një alfabet që ka shpikur vetë? Le të shohim argumentet një nga një.

Kozma Anonimi

Do t'i shtrojmë në vijim argumentet pro dhe kundër një hipoteze të tretë, për të sjellë një pikëpamje sa më të qartë. Së pari, (1) është vetëm një burim i drejtpërdrejtë që flet për Kozmain e Durrësit si autor të teksteve në gjuhën shqipe, pra teksti i Anastas Mihailit (c. 1710), dhe deri më tash është vetëm një studiues, Minaoglou (2013), që përmes këtij burimi e propozon Kozmain si autor të alfabetit të *Anonimi i Elbasanit*.²¹ Për Grigorin e Durrësit Domi kishte argument gjithashtu vetëm një shënim, atë të Zaviras (bërë dikur para vitit 1804)²² që u përmend më sipër. Nëse i vendosim pranë njëra-tjetrës dëshmitë e Mihailit me atë të Zaviras, atëherë ajo për Grigorin e Durrësit mund të duket më bindëse për shkak se teksti i Zaviras është formuluar më qartë nga pikëpamja gjuhësore.²³ Por kjo nuk mund të merret si provë me peshë definitive.

Domi në studimin e tij jep si argument shtesë qëndrimin e Grigorit si metropolit i Durrësit pikërisht në manastirin e Gjon Vladimirit, ku është gjetur dorëshkrimi (1965: 272), megjithëse gjurmë faktike të tij nuk janë gjetur asnjëherë atje. Në këtë pikë gjërat qëndrojnë më ndryshe për Kozmain (2), për të cilin jo vetëm kemi dëshmi se ka jetuar atje, por janë

21 Duhet theksuar se Minaoglou duke mos u thëlluar çështjen që po shtjellojmë, nuk e kundërshton Grigorin e Durrësit si autor të *Anonimit*, vetëm e propozon Kozmain si autor të mundshëm të alfabetit original që përdoret aty.

22 Zaviras vdiq në vitin 1804, kurse shënimet e tij bibliografike u botuan shumë më vonë, në vitin 1872.

23 Paragrafi i Anastas Mihailit për Kozmain është i vështirë për t'u kuptuar për shkak të përdorimit të greqishtes së vjetër, megjithëse duket e padiskutueshme se aty flitet për një lloj alfabeti.

shënimet e kodikut të këtij manastiri me njësi të tëra të shkruara prej tij e për të. Me këtë s'duam të themi se Grigori, që ka mbajtur pozitën e njëjtë si Kozmai (atë të mitropolitit të Durrësit), s'paska jetuar kurrë në këtë manastir, vetëm se, gjurmët e tij aty nuk janë gjetur deri më sot. Është e mundur që Grigori të ketë qëndruar më shumë në Voskopojë ose gjetiu për shembull, dhe kështu përkthimet e tij në gjuhën shqipe të jenë mbajtur tjetërkund.²⁴

Te dëshmitë e tjera dytësore duket se argumentet për Kozmain mund të jenë edhe më bindëse. Për shembull, Zamputi, vuri re te gjuha e *Anonimit të Elbasanit* fjalë të arbëreshëve të Italisë. E gjithashtu ai mbështeti idenë se autori i *Anonimit* duhet të ketë pasur njohuri për tekstet e autorëve të vjetër të Veriut:

Sa për lidhjet me Italinë prej nga, sipas kumtesës, autori i dorëshkrimit mund të jetë vu në kontakt me autorët tanë të vjetër, ndikimi i të cilëve hetohet në dorëshkrim, do të vërejmë se këto lidhje, sidomos në terrenin kishtar-ortodoks, në të cilin terren ka lindë dorëshkrimi ynë, kanë qenë edhe ma të mëdha në shekujt XVI-XVII se sa në të XVIII-tin. (Zamputi 1965: 400)

Ky përshkrim për autorin e dorëshkrimit elbasanas në fakt përputhet mjaft mirë me figurën e Kozmait (3), i cili kishte studiuar në Kolegjin e Shën Thanasit në Romë, e gjithashtu kishte pasur kontakt edhe me personalitete nga Propaganda Fide,²⁵ ku kishte studiuar. Bogdani për shembull, vetëm pak vite para se Kozmai të vendosej atje.²⁶ Kolegji i Shën Thanasit kishte qenë shkolla më e rëndësishme për arbëreshët e Italisë, por ku rëndom ndiqnin studimet edhe ortodoksë nga Perandoria Osmane. Prandaj nuk është aspak e pamundur që atje Kozmai të ketë mësuar edhe për gjuhën shqipe, por edhe të jetë miqësuar me qarqet intelektuale shqiptare.

Domi gjithashtu kishte theksuar ndikimin sllav në alfabetin e shpikur të *Anonimit*. Sipas tij, kjo duhet të ishte dëshmi se autori duhet të vinte nga një rreth si ai i Patriarkanës së Ohrit, që ishte në përgjithësi i përbërë nga

24 Në këtë pikë nuk është për t'u përjashtuar edhe mundësia që alfabeti i Theodor Haxhifilipit të ketë qenë në fakt ai i Grigorit të Durrësit, të cilin Haxhifilipi e kishte mësuar në Voskopojë. Një gjë të tillë e ka sinjalizuar edhe Shuteriqi herë pas here (Shuteriqi 1962: 149; Shuteriqi 2020: 5). Në vitin 1850 në shënimet e para për Theodorin edhe Hahn e kishte ngritur këtë çështje: "nuk e di nëse alfabetin e kishte shpikur vetë apo vetëm e kishte sjellë në Elbasan" (Hahn 1850: 865). Të njëjtën gjë e përsërit më vonë edhe te *Albanesische Studien* (1853).

25 Dëshmi për këtë është një letër që Simeone Lascari, peshkopi katolik i Durrësit, e kishte dërguar nga Himara në Romë më 10 maj 1661. Në të Lascari, i dërgon shënime për certifikatën e humbur të Kozmait pikërisht sekretarit të atëhershëm të Prograpaganda Fides, Mario Albrizzi (Legrand 1902: 401).

26 Bogdani e dimë se kishte qenë në Romë edhe në vitin 1665, kur kishte dërguar një raport nga Roma për disa libra në gjuhën shqipe (Malcolm 2020: 252).

bullgarët, por edhe shqiptarët e arumunët (1965: 272).²⁷ Grigori i Durrësit, si mitropolit i Durrësit, dhe autor, korrektor e redaktor shërbesash në Voskopojë, gjithsesi i takonte këtij rrethi.²⁸ Për më shumë, në kohën kur Grigori kishte qenë në Voskopojë, kryepeshkopi i Patriarkanës së Ohrit, kishte qenë Joasafi, një voskopojar. Po e njëjta gjë qëndron edhe për Kozmain (4), i cili pa dyshim kishte qenë pjesë e rëndësishme e këtij rrethi. Ai kishte shërbyer edhe përkohësisht si kujdestar në Patriarkanën e Ohrit,²⁹ dhe në disa raste ishte zhvendosur nga Elbasani për të kaluar kohë atje. Snegarov ishte i mendimit se e njihte mirë gjuhën sllave (1932: 225).

Grigori i Durrësit, për të cilin flet Domi, është më pak i njohur në shënimet e kohës. Shënimi më i vjetër që njohim për të duhet të jetë në botimin e parë të Voskopojës rreth vitit 1731.³⁰ Emrin e tij e gjejmë në botimet e Voskopojës si tipograf, redaktor, korrektor e autor deri në vitin 1744.³¹ Emrin e lindjes e kishte pasur Grigor Kostandini. Nuk dihet për vendin apo datën e tij të lindjes. Iluministi bullgar Parteni Pavlovic në disa shënime të tij që datojnë më 21 qershor 1749, e përmend Grigorin si patriark të Durrësit dhe si ish mësues në Berat (Pavlovic 1905: 430). Referimi më i rëndësishëm për Grigorin është ai i Zavirës, që përmendëm më lart. Në atë tekst, përveç përkthimeve shqipe me alfabetin e krijuar, Grigori përmendet edhe për botimet e tij në Voskopojë dhe si nxënës i filozofit voskopojar Ioannis Chalkeus, i cili kishte dhënë mësim në Venedik, por edhe në Voskopojë. Diku në vitin 1748 duhet të jetë emëruar mitropolit i Durrësit dhe është e mundur që në këtë kohë dikur të jetë shpërngulur në Elbasan (Domi 1965: 275; Rugova 2022: 118). Ka vdekur në vitin 1772. Botimi i tij i parë i plotë si autor është shërbesa e shenjtorit të ri nga Berati, Shën Nikodemit në vitin 1741.³² Kishte përpiluar edhe shërbesën për Shtatë Shenjtorët e

27 Këtë pjesën e fundit e gjejmë si ide edhe te Glezer, shih më lart.

28 E megjithatë nuk kemi dëshmi që ai të ketë njohur ndonjë gjuhë sllave.

29 Për shembull në një sinod të vitit 1685 ishte nënshkruar si *epitrop* i përkohshëm i Ohrit, *Τοποτηρητής και ἐπίτροπος Ἀχριδῶν, Κυττιαιων Κοδμας* (Glezer 1902: 52). Nga viti 1690 deri më 23 shkurt 1694, e kishte mbajtur edhe kodikun e Patriarkanës së Ohrit, të cilën edhe e kishte riorganizuar (Snegarov 1932: 276–7).

30 Botimi i parë i Voskopojës kishte qenë shërbesa e Theodorës së Selanikut. Aty Grigori kishte nënshkruar në parathënien e shërbesës dhe kish shkruar megalinarionin. Si dhe në shumicën e veprave tjera të mëpasme edhe në këtë vepër e kishte bërë edhe shtypshkrimin (Peyfuss 2012: 95–6).

31 Maximilian Peyfuss, që ka bërë një studim të thelluar mbi shtypshkronjën e Voskopojës dhe botimet e saj, mendon se Grigori kishte punuar në shtypshkronjë deri në vitin 1769, kur ajo njihet edhe botimin e fundit aty (Peyfuss 2012: 83–90). Evlogji Kurilla, në anën tjetër, vë re se emri i Grigorit figuron në botimet e Voskopojës vetëm deri në vitin 1744 (Kurilla 1931: 59). Ne i qëndrojmë mëtimit të Kurillës, siç edhe e kemi shtjelluar tjetërkund (Rugova 2022: 118–9).

32 Nikodemi është shenjtor nga Berati, të cilin e vranë autoritetet osmane në vitin 1709 për shkak të aktivitetit të tij si predikues ortodoks. Emrin e kishte pasur Nikollë Dede

Ohrit. Të dyja këto përzgjedhje botimesh flasin për frymën autoktoniste të tij. Sipas Domit, nëse nuk kishte qenë vendas, atëherë dialektin duhet ta ketë mësuar në Elbasan, gjatë kohës kur jetonte aty. Dhe kështu do të shpjegohej edhe përzierja e dialekteve në gjuhën e tij (Domi 1965: 275). Nuk ka dëshmi, për shembull, që zanatin e tipografisë ta kishte mësuar në Venedik, edhe pse një gjë e tillë është mëtuar në vazhdimësi (Peyfuss 2012: 90). Sakaq, përveçse në Berat, Voskopojë, Elbasan e Stamboll nuk duket të ketë qenë ndonjëherë në vende të tjera.

Gjuha te *Anonimi i Elbasanit* përveçse është një përzierje dialektesh, me ndikim nga arbëreshët dhe autorët e vjetër të Veriut, sipas Robert Elsie-t, ka edhe shumë pak edhe huazime nga gjuhët e tjera: vetëm tri nga latinishtja, shtatë nga turqishtja, dhe – çka është befasia më e madhe – vetëm njëzet e një nga greqishtja. Si dëshmi e përpjekjeve të qëllimshme të autorit për krijimin e një gjuhe të pastër, Elsie e jep shembullin kur në një rast fjala *shehër* është e fshirë me vizë, e zëvendësuar me fjalën *qutet* (Elsie 1995: 119). Në këtë kuptim, Kozmai i Durrësit shfaqet si erudit, gjë që lidhet me prezencën e tij të gjatë në Romë, ndoshta kjo përputhet më shumë me një profil të tillë të autorit. Gjithashtu, nuk duhet të anashkalojmë faktin se në vitin 1690, përmes shërbesës së Shën Gjon Vladimit, kemi shkëndijat e para të mit-ndërtimit mbi baza kombëtare në këto treva. Përzgjedhja e shenjtorëve lokalë (që më vonë vijoi edhe nga Joasaf Voskopjari dhe Grigori i Durrësit) për t'u paraqitur me ekzagjerime, e gjithashtu trajtimi i mbretërve lokalë, si Karl Topia, njësoj prej një perspektive pozitive, duke valorizuar veçoritë e vendorëve, gjithsesi jep shenja të një konstrukti të qëllimshëm identitar. Të tilla konstrukte për popujt e Ballkanit, në formë moderne, kemi parë vetëm në shekullin XIX. Por në shekullin XVII synimi kryesor ishte përhapja dhe ruajtja e fesë. Kleri katolik shqiptar të paktën një shekull më parë e kishte nisur diçka të tillë (cf. Molnar 2019).

Në Romë, në fillim të shekullit XVII, me synim përhapjen e katolicizmit në vendet e orientit, ishin zhvilluar disa projekte për përkthimin në gjuhë lokale të shkresave fetare. Ndër më të njohurat janë *Tipografia Medicaea* (1584), dhe *Propaganda Fide* (1622). Në kuadër të këtyre projekteve gjejmë edhe përkthimet e para në gjuhën shqipe nga Pjetër Budi, Frang Bardhi e Pjetër Bogdanit për shembull. Në anën tjetër, ndër popujt e Ballkanit, siç u përmend dhe më lart, Patriarkana e Stambollit jo vetëm që nuk stimulonte përdorimin e gjuhëve lokale, por i shtypte ato me masa të rrepta.³³ Është

dhe vinte nga Berati. Në një letër dërguar në Stamboll të datuar 20 mars 1692 mund të shihet emri i tij si nënshkrues (Snegarov 1932: 528). Një jetëshkrim shkencor për jetën e tij mbetet për t'u bërë.

33 Rajko Nachtigall tregon një dëshmi nga shkrimtari serb Dositej Obradovic (1739–1811) në shekullin XVIII për rreziqet e përdorimit të greqishtes vernakulare: "...ka botuar një libër në gjuhën e thjeshtë greke, [...] të gjitha kopjet ia kanë djegur, e për pak ka shpëtuar të mos e djegin edhe atë bashkë me librat; sikur të kishin guxuar nga

e mundur që autoktonizmi i Kozmait të ketë qenë i frymëzuar nga qasja katolike e përhapjes së fesë, veçanërisht nga aktiviteti dinamik i Romës në këtë drejtim, sa kishte qenë atje. Sa i përket gjuhës shqipe, është e mundur që ideja për një alfabet të ketë lindur pikërisht për shkak se shqipja nuk e kishte një të tillë. Ndërkohë që bullgarët e serbët e kishin shkrimin e tyre cirilik, grekët shkrimin grek, shqiptarët mbeteshin të vetmit që për gjuhën e tyre huazonin germa nga gjuhë të tjera, dhe kjo mbase në kontekstin e kohës shihej si faktor cingues. Prandaj edhe s’duket fare jashtë kohe thënia nga Anastas Mihail Maqedonasi, “...sikundër kombet e tjera urtinë e tyre e shkruajnë nëpër libra, këtë urti ata [shqiptarët], e përthekojnë ... vetëm përmes rrëfimeve.”³⁴

Përfundim

Dukuria e krijimit të alfabeteve origjinale për gjuhën shqipe, me dëshminë e Mihailit, provohet të ketë ekzistuar që në kapërcyell të shekullit XVII, në një periudhë mes viteve 1682 dhe 1702 kur Kozma Mavrudit ka vepruar në Elbasan. Për më shumë, kjo dëshmi provon se gjuha shqipe është shkruar në mjedisin ortodoks shqiptar edhe në këtë hark kohor. Dëshmia e paraqitur hedh dritë mbi figurën e priftit kosmopolit Kostandin Mavrudit, të njohur si Kozmai, që duket të ketë qenë promovues i një qasjeje lokale të krishtërimit ortodoks që merr formë nga historia e përbashkët e shqiptarëve, bullgarëve e arumunëve. Pas gjasash, nga ky kënd mund të kundrohët edhe angazhimi i tij për të shkruar edhe në gjuhën shqipe me një alfabet të shpikur nga vetë ai.

Mbi të gjitha shfaqet si hipotezë e qëndrueshme fakti se Kozmai i Durrësit mund të ketë qenë autor i tekstit dhe alfabetit të *Anonimi i Elbasanit*, dokument i mirënjohur për studiuesit e teksteve shqipe, që mëtohet të jetë shkruar diku në fund të shekullit XVII, apo në shekullin XVII. Nëse asgjë tjetër, ksombla e mbijetuar e Mihailit rihap shtigje të reja kërkimi për shqipen e shkruar dhe alfabetet origjinale në një periudhë historike, që siç duket ka ende hapësirë për të prodhuar njohuri të reja.

BIBLIOGRAFIA

Caka, Eduart. *Vakëfjet dhe funksioni i tyre në qytetin e Elbasanit gjatë shekullit XVII*, në “Studime Historike”, Tiranë: Instituti i Historisë, 2016 Nr. 1–2, f. 99–113.

Delikani, Kallinikou: Δελικανή, Καλλινίκου. *Τα εν τοις κώδιξι του*

turqit...” (Nachtigal 2015: 86)

34 Në paragrafin paraprak Mihail Maqedonasi flet për bullgarët dhe grekët.

- Πατριαρχικού Αρχιεπισκοπείου σωζόμενα επίσημα εκκλησιαστικά έγγραφα (Vëll I). Stamboll: Εκ του Πατριαρχικού Τυπογραφείου, 1902.
- Τα εν τοις κώδιξι του Πατριαρχικού Αρχιεπισκοπείου σωζόμενα επίσημα εκκλησιαστικά έγγραφα (Vëll II). Stamboll: Εκ του Πατριαρχικού Τυπογραφείου, 1904.
- Τα εν τοις κώδιξι του Πατριαρχικού Αρχιεπισκοπείου σωζόμενα επίσημα εκκλησιαστικά έγγραφα (Vëll III). Stamboll: Εκ του Πατριαρχικού Τυπογραφείου, 1905.
- Demiraj, Bardhyl. *Enigma filologjike në Gravurën e Ardenicës*, në “Shêjzat” 2019, Viti 4, Nr 1–2, f. 101–28.
- Domi, Mahir. *Rreth autorit dhe kohës së dorëshkrimit elbasanas me shqipërim copash të ungjillit*, në A. Kostallari, “Konferenca e parë e Studimeve Albanologjike. Tiranë, 15-21 nëndor 1962”, Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, 1965, f. 170–7.
- Elsie, Robert. *Early Albanian Bible Translations in Toghri Scrip*. Londër: Kindle Edition 2016.
- *Albanian Alphabets borrowed and invented*. Londër: Kindle Edition 2017.
- *Historical Dictionary of Albania*. Londër: Rowman & Littlefield, 2010.
- *Histori e Letërsisë Shqiptare*. Pejë: Dukagjini 1997.
- *The Elbasan Gospel Manuscript (Anonimi i Elbasanit), 1761, and the struggle for an original Albanian alphabet*, në “Südost-Forschungen”, Mynih: Leibniz-Institute for East and Southeast European Studies, 1995, Vol. 54, f. 105–159.
- *Early Albania, a Reader of Historical Texts, 11th - 17th Centuries*. Wiesbaden: Otto Harrassowitz 2003.
- Giakoumis, Konstantinos. *Unpublished Icon of St. John Vladimir and a typological classification of the Saint’s imagery*, në “Crkvene studije”, Nish: 2014, 35-42, f. 169.
- Gelzer, Heinrich. *Der Patriarchat von Achrida. Geschichte und Urkunden*. Leipzig: Teubner 1902.
- Kozmai, Kostandin Mavrudi. *Άκολουθία τοῦ ἁγίου ἐνδόξου Βασιλέως καὶ Μεγαλομάρτυρος Ἰωάννου τοῦ Βλαδιμήρου καὶ Θαυματουργοῦ*. Venedik: I. Αντωνιω, Αδελφοί 1690.
- Kozmai, K. M. et al. *Άκολουθία τοῦ ἁγίου ἐνδόξου Βασιλέως καὶ Μεγαλομάρτυρος Ἰωάννου τοῦ Βλαδιμήρου καὶ Θαυματουργοῦ*. (Botimi i tretë) Venedik: Ἁγίου Γεωργίου 1858.
- Kurilla, Evlogji: *Ευλόγιος Κουρίλας. Γρηγόριος ο Ἀργυροκαστρίτης*. Τε: Θεολογία, Τεύχος 1, Αθινῆ: Φοίνικος, 1931, f. 47–63.
- Legrand, Emile. *Bibliographie Hellenique, 17e siecle*. Paris: J. Maisonneuve et E. Guilmoto 1903, Vëll V.

- Llukani, Andrea. *Mitropolia e Korçës*. Tiranë 2020.
- Malaj, Edmond. *Kulti i Shën Gjon Vladimirit tek shqiptarët sot*, në “Tivari me veçantitë shestanase në rrjedhën e shekujve”, Tiranë: Don Gjon Buzuku Qendra e Studimeve Albanologjike, 2017, f. 459–473.
- Malcolm, Noel. *Rebelët, besimtarët, të mbijetuarit*. Prishtinë: Artini 2020
- Minaoglou, Charalampos: Μηνάογλου, Χαράλαμπος Αθ. Ο Αναστάσιος Μιχαήλ ο Μακεδών και ο Λόγος περί Ελληνισμού. Athinë: 2013.
- *Anastasios Michael Macedo and his Speech on Hellenism*. Te: Acta Societatis Morgensternianae, Tartu: University of Tartu Press 2018, VI–VII, f. 115–29.
- *Greek Travellers and Travel Literature from the Fifteenth to the Eighteenth Century*, në E. Close, M. Tsianikas and G. Couvalis (red.) “Greek Research in Australia: Proceedings of the Sixth Biennial International Conference of Greek Studies, Flinders University June 2005”, Adelaide: Flinders University Department of Languages — Modern Greek, 2007, f. 305–312.
- Mihaili, Anastas: Ἀναστάσιος Μιχαήλ. *Λόγος περί Ἑλληνισμού*. Amsterdam: [1710]
- Molnár, Antal. *The Catholic Missions and the Origins of Albanian Nation-Building at the Beginning of the 17th Century*, në K. Csaplár-Degovics (Ed) “These were hard times for Skanderbeg, but he had an ally, the Hungarian Hunyadi”. Episodes in Albanian–Hungarian Historical Contacts. Budapest, 2019. (Acta Balcano-Hungarica, 1.) f. 67–91.
- Nachtigal, Rajko. *Për një gjuhë të përbashkët letratre shqipe*. Prishtinë: ASHAK, 2015.
- Nedeski, Viktor. *New discoveries for the hellenophone hagiographie and hymnographic tradition about Saint John Vladimir*, në D. Borozan (red.) “1000-godišnjica svetog Jovana Vladimira”, Podgoricë 2017, f. 41-58.
- Novaković, Stojan: Новаковић, Стојан. *Први основи словенске књижевности међу балканским Словенима: легенда о Владимиру и Косари: културно историјске студије*. Beograd: Држ. штампарији Краљевине Србије, 1893.
- Pavlovic, Partenij: Партеније Павловић. *Аутобиографија*. Те: Српски Сион, Nr. 15, Srem: Српској манастирској штампарији, 1905, f. 430-2.
- Petit, Louis. *Bibliographie des acolouthies grecques*. Bruxelles: Societe des Bollandistes 1926.
- Peyfuss, Max Demeter. *Shtypshkronja e Voskopojës 1731–1769*. Tiranë: SHLK 2012 (përkthyer nga Gjergj Misha).
- Rëmbeci, Andi. *Church services (akolouthia) in honor of St. John Vladimir in the Albanian-speaking west Balkans in the context of the spread and*

- consolidation of his veneration*, në D. Borozan (red.) "1000-godišnjica svetog Jovana Vladimira", Podgoricë 2017, f. 77-95.
- Rugova, Yll. *Tipografia shqiptare 1555-1912*. Prishtinë: Varg 2022 (në shtyp).
- Saraçi, Alvin. *Tregtia Adriatike e Shkodrës me Republikën e Venecies në shekujt e XVII dhe XVIII* (Tiranë: ASA 2016), punim doktorate.
- *Marrëdhëniet tregtare të Shqipërisë me Venecian ndërmjet portit të Durrësit në kapërcyell të shekujve XVII-XVIII*. Në: "Studime Historike," Tiranë 2021, Viti 75, Nr 1-2, f. 37-68.
- Sathas, Kōnstantinos N. *Bibliotheca græca Medii Ævi* (Vëll III). Venedik: Typois toi Foinikos, 1877.
- Snegarov, Ivan: Снегаровъ, Иванъ. *Охридска архиепископија, организација на цркви, црковни лица*. Sofje: НУБ Св. Климент Охридски 1932.
- Shuteriqi, Dhimitër. *Bibliografi e letërsisë së vjetër shqipe (1332-1850)* — *Shekulli XVIII*, në "Buletin i Shkencave Shoqërore," Tiranë 1962, Vol 16, Nr. 2, f. 139-68.
- *Diskutim rreth kumtesës së prof. M. Domit*, në A. Kostallari, "Konferenca e parë e Studimeve Albanologjike. Tiranë, 15-21 nëndor 1962", Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, 1965, f. 396-8.
- *Historia e letërsisë shqipe*. (Vol I-II). Prishtinë: Enti i teksteve 1971.
- *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*. Prishtinë: Rilindja 1978.
- *Elbasani dhe kultura e vjetër e tij*, në "Rilindasi," Viti 2, Nr 29, Tiranë: Shqiptarja 2017, f. 16-7.
- *Arsimi dhe kultura në qytetin e Voskopojës në shek. XVIII*, në B. Hudhri (bot.) "Exlibris", Tiranë: Onufri 2020, Viti 2, Nr 64, f. 4-5.
- Zamputi, Injac. *Diskutim rreth kumtesës së prof. M. Domit*, në A. Kostallari, "Konferenca e parë e Studimeve Albanologjike. Tiranë, 15-21 nëndor 1962", Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, 1965, f. 399-400.
- Zaviras, Georgio: Γεώργιος Ζαβίρας. *Νέα Ελλάς*. Athinë: Ephēmeridos tōn Syzētēseōn 1872.